

VENDIM
Nr. 148, datë 30.9.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SHA PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT
NR. 131, DATË 15.8.2016,
TË BORDIT TË ERE-s, “MBI NDËRPRERJEN E PROCEDURËS SË SHPALLUR
NGA SHOQËRIA KESH SHA “FTESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR
MARRËVESHJEN KUADËR PËR DEPOZITIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s dhe nenit 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a., për rishikim e vendimit nr. 131, datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH sh.a. “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a. ka marrë dijeni për vendimin e ERE-s nr. 131 datë 15.8.2016 nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 626 prot., datë 22.8.2016.

- Shoqëria KESH sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën nr. 7376/1 datë 31.8.2016, protokolluar me tonën nr. 626/1, datë 1.9.2016 për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 131, datë 15.8.2016 “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”.

- Shoqëria KESH sh.a. ka depozituar në vijim në ERE shkresën nr. 7376/2, datë 27.9.2016 “Në vijim të kërkesës drejtuar Bordit të ERE-s me shkresën 7376/1, datë 31.8.2016, me objekt “Kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 131, datë 15.8.2016”.

- Pika 5, e nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 16 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016”, parashikon se: “Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.”.

- Kërkesa e KESH sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 131, datë 15.8.2016, është depozituar jashtë afatit të parashikuar më sipër.

- Shoqëria KESH sh.a. ka paraqitur në ERE si prova të reja, si më poshtë:

- Procedura e filluar dhe shpallur në faqen zyrtare të KESH sh.a “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”, është finalizuar nga ana e KESH sh.a. me kontratën nr. 6549 prot., datë 27.7.2016.

- Në zbatim të vendimit nr. 131 datë 15.8.2016, të Bordit të ERE-s, KESH sh.a. ka pezulluar veprimet e mëtejshme për zbatimin e kontratës nr. 6549 prot., datë 27.7.2016.

- Procesi i depozitimit të energjisë elektrike, do të garantonte të ardhura për KESH sh.a. në një vlerë tregu prej 5 milionë euro për 6-mujorin e parë të vitit 2016.

- KESH sh.a. në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, duke marrë në konsideratë interesin publik për garantimin e furnizimit me energji elektrike, si dhe shfrytëzimin eficient të energjisë elektrike, në konsultim me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë, t’i japë zgjidhje situatës së menaxhimit të energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha me rregullimin në legjislacionin mbështetës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e KESH sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 131, datë 15.8.2016 mbështetur në pikën 5, të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në nenin 16 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, depozituar jashtë afatit të parashikuar në ligj.

2. KESH sh.a. në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, për qëllime të interesit publik, garantimit të furnizimit me energji elektrike, si dhe shfrytëzimin eficient të energjisë elektrike, në konsultim me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë, të adresojë menaxhimin e energjisë elektrike mbështetur në legjislacionin përkatës pas përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik, të parashikuar në ligj.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a., Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti